



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.0802-382**  
**5.1.2024**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, Vendimin PA1 nr.08-382 datë 25.12.2023 për heqjen e lejes për transmetim në radio Institucionit të arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit – Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP, PA1 nr.08-333 datë 9.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-93/1 datë 5.1.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 1-rë mbajtur më 4.1.2024 miratoi:

**Aktvendim**  
**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Institucioni i arsimit të lartë privat Universiteti i Shkupit – Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim është përfundimtar.

**A r s y e t i m**

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele - LSHMAAV, leja e transmetimit për televizion ose radio pushon të vlejë në bazë të ligjit, me marrjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) të nenit të cituar të Ligjit, Agjencia do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesit nëse leja pushon të vlejë në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV-së.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 42-të mbajtur më 25.12.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4741/2 datë 25.12.2023, miratoi Vendimin PA1 nr.08-382 datë 25.12.2023 për marrjen e lejes të Institucionit të arsimit të lartë privat (PVU) Universiteti i Shkupit – Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës

UNIVERZUM SHKUP, PA1 nr.08-333 datë 9.10.2023, për shkak se zotëruesi i lejes për më shumë se 30 ditë nga dita e fillimit të kryerjes së veprimtarisë, të përcaktuar në leje, nuk ka plotësuar kushtet teknike dhe hapësinore që ka ofruar në procedurën e dhënies së lejes, pra kushtet hapësinore dhe teknike të transmetuesit nuk kanë qenë në pajtim me kushtet hapësinore dhe teknike të ofruara në procedurën e dhënies së lejes PA1 nr.08-333 datë 9.10.2023, të cilat janë paraqitura në Formularin nr.2 i cili është pjesë përbërëse e Aplikimit për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes PA1 nr.08-187 datë 15.5.2023.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, dhe në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, nenit 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.08-382 datë 25.12.2023 për marrjen e lejes për transmetim në radio të PVU Universiteti i Shkupit – Shkup, Institucion radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM SHKUP, PA1 nr.08-333 datë 9.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-93/1 datë 5.1.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 1-rë mbajtur më 4.1.2024, miratoi aktvendimin si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.